

VENDIM
Nr. 571, datë 8.8.2019

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2019, MIRATUAR PËR
QENDRËN KOMBËTARE TË KINEMATOGRAFISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, të ligjit nr. 8096, datë 21.3.1996 “Për kinematografinë”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 99/2018 “Për buxhetin e vitit 2019”, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2019, t’i shtohet fondi prej 10 500 000 (dhjetë milionë e pesëqind mijë) lekësh, në formën e grantit për Akademinë e Filmit dhe Multimedias “Marubi”, për mbështetjen e veprimtarive krijuese.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2019.

3. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama